

ALPIQ ENERGY ALBANIA SHPK

Pasqyra e Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 15

Alpiq Energy Albania shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	7,115,920	13,003,335
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	-	760,139
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	18,250,200	8,712,519
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	680,413	2,429,575
Shpenzime të shtyra	8	258,601	193,769
Totali i aktiveve afatshkurtra		26,305,134	25,099,337
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	352,446	386,151
Të tjera llogari të arkëtueshme afatgjata	10	291,848	291,848
Totali i aktiveve afatgjata		644,294	677,999
Totali i aktiveve		26,949,428	25,777,336
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	371,487	1,929,229
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	8,914,494	5,629,655
Hua nga palët e lidhura	13	15,621,625	15,889,525
Detyrime tatimore	14	374,788	140,206
Të tjera detyrime	15	535,381	936,562
Totali i detyrimeve afatshkurtra		25,817,775	24,525,177
Totali i detyrimeve		25,817,775	24,525,177
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	16	17,625,000	17,625,000
Fitime/(Humbje) të mbartura		(16,372,841)	(16,482,114)
Humbja e ushtrimit		(120,506)	109,273
Totali i kapitalit		1,131,653	1,252,159
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		26,949,428	25,777,336

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15 , të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Alpiq Energy Albania Shpk

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	9,537,681	1,482,884
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	(14,511)	(142,112)
Të tjera shpenzime	19	(6,355,246)	(6,684,046)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të			
1) tjera		-	(1,475,521)
2) Të tjera shpenzime		(6,355,246)	(5,208,525)
Shpenzime të personelit	20	(2,826,284)	(3,045,228)
1) Paga dhe shpërblime		(2,442,356)	(2,668,051)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(383,928)	(377,177)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	21	(84,900)	(106,303)
Shpenzime financiare	22	(9,722)	8,715,636
Shpenzime interesi dhe shpenzime			
1) të ngjashme		(235,757)	(242,208)
2) Shpenzime të tjera financiare		226,035	8,957,844
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		247,018	220,831
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	(367,524)	(111,558)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi			
1) fitimin		(367,524)	(111,558)
Fitimi/humbja e vitit		(120,506)	109,273
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(120,506)	109,273

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Alpiq Energy Albania Shpk
(Merat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Pozicioni më 1 janar 2016	Kapitali i nënshkruar	Fitim/(Humbje) Pashpërdarë	Fitim / (Humbja) e vitit	Totali
Fitimi / (Humbja) e vitit	17,625,000	(16,594,258)	112,144	1,142,886
Transferime ne fitim/(humbje) te mbartura		112,144	(112,144)	109,273
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	17,625,000	(16,482,114)	109,273	1,252,159
Fitimi / (Humbja) e vitit			(120,506)	(120,506)
Transferime ne fitim/(humbje) te mbartura		109,273	(109,273)	
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	17,625,000	(16,372,841)	(120,506)	1,131,653

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i shoqërisë "Alpiq Energy Albania" Shpk më 26/03/2018 dhe janë firmosur si më poshtë.

Anastasia Krivosheeva,
Administrators



Mazars shpk

Mazars Shpk



Rr. Emin Duraku, Pall "Bajkete",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@ mazars.al

Alpiq Energy Albania Shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Notes	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / (Humbja) e vitit	(120,506)	109,273
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(211,524)	(98,763)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	84,900	106,303
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e AAM	25,855	
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(6,677,496)	(455,670)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	1,292,607	2,667,795
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(5,606,164)	2,328,938
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(77,050)	(14,455)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(77,050)	(14,455)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(5,683,214)	2,314,484
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	13,003,335	10,901,101
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(204,201)	(212,250)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	7,115,920	13,003,335

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

"Alpiq Energy Albania" shpk, me NIPT K91906013R është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si një kompani me përgjegjësi të kufizuar me 06/07/2009.

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është Transport dhe shitje e energjisë, shitje, prodhim, përfaqësim tregtar dhe agjensi.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në rrugën "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Sky Tower Bldg.

Më 31 dhjetor 2017 shoqëria kishte 2 punonjës (2016: 2 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënime të pasqyrave financiare.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/LEK	132.95	135.23

3.2. Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Shoqëria në fillim regjistron aktivët dhe detyrimet financiare me vlerën e tyre të drejtë.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse në bankë.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Normat e amortizimit per efekt fiskal për vitin aktual janë si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iii. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe fitim/humbjet nga kursi i këmbimit që lidhen me to.

3.5 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

Alpiq Energy Albania Shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	7,038,204	12,706,262
Në lekë	22,939	9,008
Në monedhë të huaj	7,015,265	12,697,254
Mjete monetare në arkë	77,716	297,073
	<u>7,115,920</u>	<u>13,003,335</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari të arkëtueshme tregtare	-	760,139
	<u>-</u>	<u>760,139</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të tjera llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	18,250,200	8,712,519
	<u>18,250,200</u>	<u>8,712,519</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
TVSH për tu rimbursuar	680,413	2,316,632
Tatim Fitim i parapaguar	-	111,308
Debitorë kreditorë të tjerë	-	1,635
	<u>680,413</u>	<u>2,429,575</u>

8. Shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Paradhënie për punonjësit	198,601	71,009
Parapagime të dhëna	60,000	-
Paradhënie për qera	-	122,760
	<u>258,601</u>	<u>193,769</u>

Alpiq Energy Albania Shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Mobilje dhe orendi	Kompjuteri	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2016	818,007	681,799	1,499,806
Shtesa	14,455	-	14,455
Gjendja më 31 dhjetor 2016	832,462	681,799	1,514,261
Shtesa	-	77,050	77,050
Nxjerrje jashtë përdorimit	(62,659)	(94,360)	(157,019)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	769,803	664,489	1,434,292
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2016	544,427	477,389	1,021,816
Amortizimi i vitit	55,201	51,102	106,303
Gjendja më 31 dhjetor 2016	599,628	528,491	1,128,119
Amortizimi i vitit	46,573	38,327	84,900
Nxjerrje jashtë përdorimit	(52,281)	(78,883)	(131,164)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	593,917	487,929	1,081,846
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor 2016	232,834	153,308	386,151
Gjendja më 31 dhjetor 2017	175,886	176,560	352,446

Alpiq Energy Albania Shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

10. Të tjera llogari të arkëtueshme afatgjata

Llogaritë e tjera të arkëtueshme afatgjata më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Garanci për qera	235,348	235,348
Roaming Deposit (Vodafone)	56,500	56,500
	<u>291,848</u>	<u>291,848</u>

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorë	371,487	1,929,229
	<u>371,487</u>	<u>1,929,229</u>

12. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	8,914,494	5,629,655
	<u>8,914,494</u>	<u>5,629,655</u>

13. Hua nga palët e lidhura

Huatë nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Alpiq Ltd	13,295,000	13,523,000
Atel Energy SE	2,326,625	2,366,525
	<u>15,621,625</u>	<u>15,889,525</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Tatim fitim	228,324	-
Tatim mbi të ardhurat Personale	61,705	64,382
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	58,913	57,147
Tatim në burim	25,846	18,677
	<u>374,788</u>	<u>140,206</u>

Alpiq Energy Albania Shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të tjerë debitorë dhe kreditorë	292,477	684,048
Paga të pagueshme	242,904	252,514
	<u>535,381</u>	<u>936,562</u>

16. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 17,625,000 lekë.

Humbje e akumuluar

Humbja e akumuluar e Shoqërisë është (16,372,841) lekë.

Humbja e ushtrimit

Shuma prej (120,506) lekë përfaqeson humbjen për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017.

17. Të ardhurat

Shoqëria gjatë vitit 2017 dhe 2016 ka realizuar të ardhura si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga kryerja e shërbimeve	9,537,681	1,482,884
	<u>9,537,681</u>	<u>1,482,884</u>

18. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Humbje nga këmbimet e llogarive tregtare	(352,797)	(324,378)
Fitim nga këmbimet e llogarive tregtare	338,286	182,266
	<u>(14,511)</u>	<u>(142,112)</u>

Alpiq Energy Albania Shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Mbyllje TVSH-je	1,881,895	-
Shpenzime të tjera	1,484,367	1,997,601
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	-	1,475,521
Shpenzime qeraje	1,368,092	1,401,021
Shërbime nga të tretë	804,800	885,546
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	288,721	331,853
Komisione bankare	110,174	107,584
Taksa të ndryshme	104,830	101,000
Anëtarësime	99,836	154,525
Mirëmbajtje dhe Riparime	93,100	33,280
Blerje Energji	45,623	41,031
Shpenzime Transporti	44,000	63,783
Vlera kontabël e aktiveve të shitura	25,855	-
Blerje të ndryshme, kancelari, etj	3,953	91,300
	<u>6,355,246</u>	<u>6,684,046</u>

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

Shpenzimet e personelit deklaruar në Drejtorinë Tatimore janë 3,216,836 lekë. Mospërputhja me shumën 774,480 lekë e shpenzimit të pagës bruto të deklaruar në FDP vjen si rezultat i pagës së papaguar të administratorit e cila llogaritet vetëm për efekt sigurimesh dhe nuk paguhet.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	2,442,356	2,668,051
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	383,928	377,177
	<u>2,826,284</u>	<u>3,045,228</u>

21. Shpenzime amortizimi

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime amortizimi	84,900	106,303
	<u>84,900</u>	<u>106,303</u>

22. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë, si dhe të ardhurat nga penalteti. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime Interesi	(235,757)	(242,208)
Fitim/Humbje nga këmbimet për huanë	226,035	240,875
Të ardhura nga dëmshpërblimi kontraktor	-	8,712,519
Të tjera	-	4,450
	(9,722)	8,715,636

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i Tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2016: 15%). Formularët e deklarimit të Tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore. Legjislacioni Tatimor dhe Ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Rezultati Financiar para tatimit	247,018	220,831
Shpenzime të panjohura	2,203,141	522,892
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	2,450,159	743,723
Tatim fitimi @15%	(367,524)	(111,558)
Fitim/(Humbja) Neto	(120,506)	109,273

24. Transaksionet me palët e lidhura

Gjendjet dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe më 31 dhjetor 2016 janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Alpiq Energy SE	18,250,200	8,914,494	8,712,518	5,628,416
	18,250,200	8,914,494	8,712,518	5,628,416
	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Alpiq Energy SE	9,537,681	-	8,712,518	-
Alpiq Energy SE	-	1,595,400	-	1,622,760
	9,537,681	1,595,400	8,712,518	1,622,760
	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Hua		Hua	
Alpiq Ltd	13,295,000		13,523,000	
Alpiq Energy SE	2,326,625		2,366,525	
	15,621,625		15,889,525	

Alpiq Energy Albania Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

25. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë Çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

Detyrime të ardhshme për qeranë operative

	<u>Më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Më 31 dhjetor 2016</u>
Brenda një viti	1,356,090	1,379,346
Më shumë se një vit, më pak se pesë vjet	-	-
Totali	1,356,090	1,379,346

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.